

Tarifat nxitëse dhe rëndësia e tyre për investime në Kosovë

Janar 2014



Botuar nga INDEP në kuadër të KOSID

Përgatitur nga:

Dardan Abazi (Instituti për Politika Zhvillimore - INDEP)

RinoraGojani (Instituti për Politika Zhvillimore - INDEP)

Redaktor: ShkambQavdarbasha

Copyright © 2014 INDEP

Përmbajtja

1.	Hyrje.....	5
2.	Qëllimi i punimit dhe Metodologjia.....	8
3.	Korniza Ligjore dhe Institucionale.....	10
4.	Masat nxitëse në fushën e energjisë së ripërtëritshme.....	13
5.	Rëndësia e tarifave nxitëse.....	15
6.	Tarifat nxitëse dhe llojet e tyre.....	17
a)	Lartësia e tarifave nxitëse.....	19
	Hidroenergji.....	20
	Energjia e erës.....	21
	Biomasa.....	22
	Gjeotermale.....	23
	Energjia Solare.....	23
b)	Kohëzgjatja e tarifave nxitëse.....	26
7.	Certifikatat e Gjelbra.....	28
8.	Përfundimet.....	30
9.	Rekomandimet.....	32

Shkurtesat

BE	Bashkimi Evropian
BRE	Burimet e Ripërtërithme të Energjisë
FiT	Feed-in Tarifa
HC	Hydrocentral
HCV	Hydrocentrale të vogla
KE	Komisioni Evropian
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmisionit (OST) dhe Operatori i Tregut (OT)
ktoe	Kiloton naftë ekuivalent
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
PKVBRE	Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtërithme të Energjisë
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
UA	Udhëzim Administrativ
ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

1. Hyrje

Shumë shtete janë duke përdorur tarifatat nxitëse (feed-in tarifatat) si mekanizëm për zhvillimin e energjisë së pastër. Tarifatat nxitëse janë politika ekonomike të krijuara për të nxitur investime në Burimet e Ripërtërithshmetë Energjisë (BRE). Si të tilla vendosja e tyre rregullohet me legjislacion.

Përmes tarifave nxitëse, prodhuesit e energjisë nga burimee ripërtritshme kanë garanci që energjia e prodhuar do ju blehet. Kjo garanci e blerjes është e shoqëruar me dhënien e përparësisë së blerjes në krahasim me energjinë e prodhuar nga thëngjilli, si dhe sigurimin e qasjes në rrjet. Janë pikërisht tarifatat nxitëse që detyrojnë ndërmarrjet energjetike kombëtare apo rajonale të blejnë energji të gjeneruar nga burimet e ripërtërithshme me normat e tregut të caktuara nga qeveria.

Tarifatat e para nxitëse u zbatuan nga administrata e Jimmy Carter në SHBA në fund të viteve 1970. Jimmy Carter nënshkroi Aktin Kombëtar të Energjisë për të nxitur kursimin e energjisë së bashku me zhvillimin e burimeve të reja të ripërtërithshme të energjisë, si energjinë diellore, të erës dhe gjeotermale. Që nga kjo kohë, tarifatat nxitëse janë përdorur gjerësisht në të gjithë botën, e më dukshëm në Gjermani, Spanjë dhe pjesë të tjera të Evropës.

Përvoja e shteteve që kanë zbatuar tarifatat nxitëse tregon se ato mund të përdoren për përmbushjen e disa qëllimeve të politikës në vend, duke përfshirë këtu: zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës, si dhe arritjen e objektivave shtetërore për prodhim të energjisë nga burimet e ripërtërithshme. Kjo për arsye se BRE-të bëjnë reduktimin e dioksidit të karbonit (CO₂) i cili emitohet në atmosferë; reduktojnë varësinë nga lëndët djegëse fosile; si dhe reduktojnë varësinë nga gazi, dhe rezervat e naftës, të cilat dita ditës janë duke u bërë më të shtrenjta dhe të vështirë për tu gjetur.

Te vendet në zhvillim që kanë burim energjie thëngjillin, shpesh haset në hezitim në promovimin e burimeve të ripërtërithshme të energjisë, ngase kostoja e prodhimit të energjisë nga këto burime konsiderohet e shtrenjtë. Mirëpo, praktika tregon që investimet në BRE do të

shpaguhen në afat të gjatë. Lëndët djegëse fosile mund të jenë opsioni më i lirë në afat të shkurtër, mirëpo ato si burime fundore janë shkaktarët kryesor të ngrohjes së planetit, shkaktarë të sëmundjeve të frymëmarrjes, si dhe të vdekjeve të hershme. Gjithashtu, teknologjitë e energjisë nga burimet e ripërtëritshme janë duke u bërë më të lira, si pasojë e ndryshimit teknologjik, përfitimi i prodhimit në masë dhe konkurrenca e tregut, edhe pse në afat-shkurtër, ende mbetet opsion më i shtrenjtë.

Vendet ku janë zbatuar tarifatat nxitëse, kanë parë rritje të investimeve në teknologjinë e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Ky është rasti sidomos i Gjermanisë, Danimarkës dhe Spanjës, të cilat janë përdoruesit më të mëdhenj në Evropë të energjisë alternative, veçanërisht të asaj nga era.¹

Sistemi i tarifave nxitëse në Kosovë nuk ka një traditë të gjatë dhe vetëm viteve të fundit janë bërë përpjekje për të aplikuar një politikë të tillë nxitëse. Mund të thuhet se tarifatat nxitëse janë një term gati i panjohur për publikun e gjerë. Kjo ndodh për shkak se energjia elektrike dhe thëngjilli për një kohë të gjatë ishin gati sinonime të njëra tjetrës. Tarifatat nxitëse në Kosovë u bënë të njohura më vonë, me tendencën për të përafuar legjislacionin vendor me atë të BE-së, për përmbushjen e hendekut të furnizimit me energji elektrike e cila përndryshe duhet të mbulohet nga importe me çmime shumë të larta të energjisë elektrike dhe gjithashtu me ngritjen e shqetësimeve serioze mjedisore si rezultat i djegies së thëngjillit.

Një nga objektivat strategjike të Kosovës është edhe integrimi në Bashkimin Evropian. Integrimi në BE, përveç tjerash kërkon edhe zbatimin e objektivave 20-20-20 të planit të BE-së, që do të thotë 20% reduktimi i emetimit të gazrave që krijojnë efektin serë, 20% rritje në pjesëmarrjen e burimeve të ripërtëritshme në konsumin final të energjisë, dhe 20% në përmirësimin e efikasitetit të energjisë. Andaj, përcaktimi i tarifave nxitëse për stimulimin e investitorëve, si dhe krijimi i një ambienti të përshtatshëm për investim është tejet i rëndësishëm për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, me kushte më të mira mjedisore për vendin si dhe plotësimin e objektivave shtetërore.

¹Reiche, D., Bechberger, M., 2004. Policy differences in the promotion of renewable energies in the EU member states. *Energy Policy*, 32 (7), 843–849.

Strategjia e Energjisë së Kosovës 2009-2018², ende në fuqi, fokusohet kryesisht në linjit dhe në prodhimin e energjisë nga linjiti, duke lënë anash çështjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Strategjia e Energjisë së Kosovës 2009–2018 (më tej në tekst ‘Strategjia’) përfshin studimet e kapaciteteve të linjtit, vlerësimin e gjendjes së tanishme në dy termocentralet ekzistuese dhe shqyrtimin e investimeve të reja të mundshme në linjit, por nuk përfshinë asnjë studim për format alternative të energjisë siç janë, energjia nga era, ajo solare, energjia gjeotermike, etj.

Megjithatë, Qeveria e Kosovës gjegjësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) ka miratuar kapacitetin e instaluar të nevojshëm për përmbushjen e caqeve indikative për konsum nga BRE-të për periudhën 2013-2020. Caqet e BRE-ve përcaktojnë pjesëmarrjen në përqindje në Bruto Konsumin Final të Energjisë (BKFE) që për Kosovën është 25%. Arritshmëria e këtij caku obligativ prej 25% edhe ashtu është sfidë e madhe për Kosovën. Mirëpo, me Udhëzimin Administrativ 01/2013 dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Energji të Ripërtëritshme, MZHE ka marrëpërsipër edhe një cak joobligativ prej 29.47%³.

MZHE në planin e saj kombëtar parasheh që kuotën obligative prej 25% të energjisë nga BRE-të në konsum ta arrijë kryesisht nga energjia e fituar nga uji. Sidoqoftë, për tu arritur një vlerë e tillë duhet investim i madh në të gjitha burimet e ripërtëritshme të energjisë. Mungesa e planeve strategjike, studimeve dhe matjeve të kapacitetit reale të Kosovës për prodhim të energjisë nga BRE-të e vështirësojnë arritjen e këtij obligimi. Andaj, së pari nevojiten hapa drejt plotësimit të kësaj mangësie në mënyrë që t’i hapet rrugëpërmirësimit të gjendjes energjetike dhe tërheqjes së investimeve.

Tarifat nxitëse në Kosovë janë të hartuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE). Kosova ende nuk i ka të përcaktuara tarifat nxitëse për të gjitha llojet e energjisë së ripërtëritshme. Ato ekzistojnë vetëm për burimet e energjisë së ripërtëritshme nga uji, era dhe biomasa. Mungesa e

²Kjo meqë rishikimi i Strategjisë ka filluar të ketë lëvizje tek tash në fund të dhjetorit 2013. Nga praktika shihet se aprovimi i Strategjisë bëhet një vit pasi që ajo do të duhej të hynte në fuqi. Praktikë kjo në kundërshtim edhe me vetë Ligjin për Energji. Sipas Ligjit për Energji, çdo tri vite pas hyrjes në fuqi, Qeveria është e obliguar që të rishqyrtoj Strategjinë e Energjisë.

³Planit Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (PKVBRE) 2011 - 2020. Caku joobligativ ka karakter promovues dhe shërben si bazë për vendosjen e Feed-in tarifave.

tarifave nxitëse e bën të pamundur vendosjen e bazës themelore të stimulimit dhe krijimin e ambientit të përshtatshëm për investitorët e interesuar në gjenerimin e energjisë nga burimet eripërtëritshme në Kosovë,.

2. Qëllimi i punimit dhe Metodologjia

Për të parë çfarë hapa duhet marrë në Kosovë, ky punim do të shtjellojë shkurtimisht kornizën ligjore dhe atë institucionale të rregullimit të energjisë dhe gjendjen aktuale të tarifave nxitëse në Kosovë. Mirëpo, pjesë kryesore e këtij punimi do të jetë krahasimi i tarifave nxitëse të Kosovës në raport me vendet e rajonit dhe disa nga vendet Evropiane. Ky krahasim do të shërbejë për të analizuar se sa atraktive është Kosova për investim në sektorin e energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme në raport me vendet e rajonit.

Në kuadër të anëtarësisë në Traktatin e Komunitetit të Energjisë (TKE), Direktivat BE-së dhe pajtueshmëria me *acquiscommunitaire*, për sektorin e energjisë aplikohen edhe për Kosovën.⁴ Andaj, si shtet anëtarë dhe sipas dispozitave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Kosova është e angazhuar për të rritur sasinë e prodhimit të energjisë nga burime të ripërtëritshme në portfolion e saj të përgjithshme, si dhe ka marrë përsipër transpozimin e Direktivës 2009/28/KE. Kësisoj, analizimi i përputhshmërisë së bazës ligjore të Kosovës me atë të BE-së është komponentë thelbësore e këtij punimi. Me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë së bazës ligjore me atë të BE-së dhe të nevojave praktike, është analizuar edhe kuadri ligjor vendor si Ligji për Energjinë, Ligji për Energjinë Elektrike si dhe Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2009-2018.

Metodologjia e përdorur në këtë punim është e kombinuar, sasore dhe cilësore. Në pjesën e hulumtimit sasior janë përdorur të dhëna nga raporte zyrtare të institucioneve përgjegjëse në

⁴Direktiva për Promovimin e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme, nenit 37, e cila thotë: 'Me anë të një vendimi të marrë në bazë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për burimet e ripërtëritshme, palët kontraktuese të këtij Traktati për Energji bëhen të detyruara ndaj dispozitave përkatëse të kësaj Direktive, andaj, masat e bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare të parashikuara në këtë Direktivë do të zbatohet edhe për vendet jo anëtare të BE-së'.

fushën e energjisë së ripërtëritshme. Në pjesën e hulumtimit cilësor janë realizuar intervista me përfaqësues kryesor të institucioneve që e rregullojnë këtë fushë. Në përzgjedhjen e metodologjisë së përzier ka ndikuar natyra specifike e problemit, meqë nevojiteshin të dhëna të kuantifikuara dhe analizë kualitative e tyre.

Grumbullimi i të dhënave sasiore ishte i domosdoshëm për të pasur një pasqyrë të tarifave nxitëse, lartësisë dhe kohëzgjatjes së tyre. Të dhënat e tilla janë shprehur në njësi të njëjta dhe janë paraqitur në mënyrë tabelare për të dhënë një ide më të qartë të fakteve numerike. Të dhënat sasiore janë paraqitur gjithnjë të krahasuara me vendet e tjera për të i shërbyer analizës krahasimore si një nga instrumentet kryesore të këtij punimi.

Metoda cilësore është përdorur për të analizuar shkaqet dhe për të njohur më thellë problemin në kontekst të Kosovës. Intervista me akterët kryesor të procesit politikëbërës në këtë fushë i ka kontribuar pjesës së analizës. Analiza cilësore evidenton shkaqet dhe pasojat e gjetjeve kryesore të pjesës sasiore.

Në fund, punimi përmban një sërë rekomandimesh për institucionet kryesore të vendit të cilat janë konsideruar të domosdoshme për ndryshimin e gjendjes aktuale. Rekomandimet janë hartuar duke pasur parasysh nevojat aktuale të Kosovës dhe mundësitë dhe kapacitetet institucionale për realizimin e tyre. Në këtë kuptim, rekomandimet e këtij punimi synojnë të jenë bazë e ndryshimit të politikave aktuale në drejtim të nxitjes së investimeve në fushën e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë.

3. Korniza Ligjore dhe Institucionale

Energjia nga burimet e ripërtëritshme ka qenë një nga prioritetet e politikëbërësve të Evropës dhe vendeve që aspirojnë anëtarësimin në BE. Këto prioritete janë materializuar në Direktiva të përgjithshme që kanë çuar në hartimin e legjislacionit edhe në nivel të shteteve. Direktiva Evropiane 2009/28/KE, ka vënë bazën e rregullimit të energjisë së pastër në nivel komuniteti.⁵ Duke qenë se Kosova është nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë⁶, ka pranuar përgjegjësitë që rrjedhin nga Direktiva 2009/28/KE. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, Kosova është pajtuar të harmonizojë legjislacionin vendor në fushën e energjisë dhe të sigurojë liberalizimin e tregut të energjisë.

Direktiva Evropiane, e cila vendos cakun që brenda vitit 2020 të prodhohet 25%⁷ e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, gjithashtu cakton një sërë masash që shtetet duhet të ndërmarrin për të përmbushur këtë detyrim. Për të arritur një cak të tillë ambicioz, nevojitet implementimi i masave stimuluese të prodhuesve, siç janë tarifave nxitëse. Për Kosovën pjesa e energjisë nga burimet e ripërtëritshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë për vitin 2009 ishte 18.9%⁸ ndërsa deri në vitin 2020, 25%. Për të arritur këtë cak, dhe për shkak të efikasitetit të tarifave nxitëse në stimulimin dhe sigurimin e prodhimit të energjisë së pastër, implementimi i tyre është tejet i rëndësishëm.

Sidoqoftë, Kosova nuk ka një ligj të veçantë për menaxhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe për nxitjen e investimeve në këtë sektor. Megjithatë, Ligji për Energji⁹ dhe Strategjia e Energjisë 2009-2018 prekin në vija të trasha parimet mbi hartimin e politikave në

⁵ European Parliament and Council, Directive 2009/28/EC on the promotion of the use of energy from renewable sources and amending and subsequently repealing Directives 2001/77/EC and 2003/30/EC, Marrë nga: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=Oj:L:2009:140:0016:0062:en:PDF>.

⁶ Traktati i Komunitetit të Energjisë është një komunitet i krijuar nga ana e Bashkimit Evropian me anë të një Traktati në mes BE-së dhe vendeve të treta (kryesisht të pjesës juglindore të Evropës), të cilat aspirojnë antarësimin në BE, me qëllim të harmonizimit të legjislacionit në fushën e energjisë.

⁷ Traktati i Komunitetit të Energjisë, Marrë nga: http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/AREAS_OF_WORK/RENEWABLES/Acquis.

⁸ Traktati i Komunitetit të Energjisë, <http://www.energy-community.org>.

⁹ Më Ligjin aktual për Energji kërkohet hartimi i planeve afatmesme mirëpo Direktiva Evropiane 2009/28/KE nuk kërkohet hartimin e këtyre planeve. Andaj duhet bërë rihartimi i Ligjit për Energji, ngase si I tillë nuk përkon me Direktivën Evropiane 2009/28/KE.

këtë fushë. Ndërsa, Ligji mbi Rregullatorin e Energjisë i kontribuon kompletimit të bazës ligjore duke qenë se e vë Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) si autoritetin e vetëm për përcaktimin e tarifave.¹⁰ Rrjedhimisht, Rregullatori i Energjisë është përgjegjës për përcaktimin e tarifave nxitëse të energjisë, për konsultimin paraprak të tyre me palët e interesuara dhe për arsyetimin e vendosjes së tyre. Një tjetër dokument me rëndësi është edhe Plani i Kosovës për Burimet e Energjisë së Ripërtërithme (PKBRE) 2011-2013¹¹. Dokumenti i cili deri në nëntor 2013 ishte draft, mirëpo ky dokument tashmë është i miratuar nga Qeveria e Kosovës.

Direktiva 2009/28/KE e Bashkimit Evropian obligon shtetet që të ndërmarrin masa për të nxitur investimet në fushën e energjisë së pastër. Kjo direktivë inkurajon implementimin e incentivave në nxitjen e konsumit të energjisë së pastër.¹² Këto masa janë paraparë për të arritur cakun e prodhimit të së paku 20% të energjisë totale nga BRE në nivel të Komunitetit të Energjisë. Direktiva 2009/28/KE, obligon shtetet që deri më 2020 të shfrytëzojnë një pjesë të energjisë nga biokarburantet, veçanërisht në arritjen e caktimit prej 10% të energjisë në fushën e transportit. Kjo Direktivë 2009/28/KE është baza e rregullimit të prioritetëve evropiane për energjinë nga burimet e ripërtërithme.

Ligji për Energji parasheh që të ndërmerren masa në drejtim të përmbushjes së caqeve për energjinë nga burimet e ripërtërithme. Përgjegjëse për përcaktimin e këtyre caqeve është Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE). Udhëzimi Administrativ i ri, Nr. 01/2013 ka bërë caktimin e caqeve të BRE-ve për Kosovën deri në vitin 2020, për dallim nga UA 06/2007 i cili caktonte caqet vetëm deri në vitin 2016.¹³ Tabela në vazhdim tregon nivelin e parashikuar të energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërithme deri në vitin 2020¹⁴ të shprehura në ktoe (kiloton naftë ekuivalent).

¹⁰Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-185, për Rregullatorin e Energjisë, Prishtinë 2010.

¹¹Ministria e Zhvillimit Ekonomik, http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/Plani_i_BRE_shqip_tetor2013.pdf.

¹² European Parliament and Council, Directive 2009/28/EC on the promotion of the use of energy from renewable sources and amending and subsequently repealing Directives 2001/77/EC and 2003/30/EC, 9 April 2009.

¹³Ministria e Energjisë dhe Minierave, Udhëzim Administrativ 06/2007 për Caqet Indikative për prodhimin e Energjisë Elektrike dhe termike nga burimet e ripërtërithme të energjisë dhe bashkëprodhimi, Prishtinë, 2007.

¹⁴Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2013 i Qeverisë së Kosovës.

	Burimi i Energjisë	Energjia elektrike nga BRE-të (ktoe)							
		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
1	Energjia solare		0.53	0.71	1.06	1.24	1.42	1.59	1.77
2	Biomasë solide		1.29	2.58	3.87	5.16	6.45	7.74	9.03
3	Era	0.233876	5.431125	12.126913	15.591745	19.056578	22.52141	24.253826	25.986242
4	Hidrocentrale të vogla ekzistuese	11.2554	11.2554	11.2554	11.2554	11.2554	11.2554	11.2554	11.2554
5	Hidrocentrale të reja		23.22	54.17	59.04	61.91	69.65	77.39	92.86
6	Hidrocentrali I Zhurit					34.22	34.22	34.22	34.22
7	Total i energjisë	11.49	41.72	80.84	89.82	132.84	145.51	156.45	175.13

Shënim: Marrë nga Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2013 i Qeverisë së Kosovës

Siç shihet në tabelë, deri në vitin 2020 është paraparë rritje e energjisë elektrike e prodhuar nga burimet e ripërtëritshme deri në 175.13 ktoe. Rishikimi i caqeve indikative me udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për energjinë elektrike të prodhuar nga BRE-të, dy herë më të larta se sa caku indikativ i përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2007¹⁵, shihet si zhvillim pozitiv. Sidoqoftë, nuk ka plan veprimi për hapat që duhen ndërmarrë për të mundësuar arritjen e këtyre caqeve dhe matjen e nivelit të arritshmërisë së tyre.

Garancia për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit në shërbim të prodhuesve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme është e vendosur me Ligjin për Energji. Operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes duhet t'i sigurojnë çdo prodhuesi të ri të energjisë elektrike vlerësimin e plotë e të hollësishëm lidhur me shpenzimet që krijohen nga kyçja në sistem.

¹⁵Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2007 u shfuqizua me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2013.

Operatori i sistemit mund të ngarkojë një pagesë e cila pasqyron kostot e arsyeshme të tij.¹⁶ Kjo i bën operatorët përgjegjës për të mbështetur prodhuesit e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme.

4. Masat nxitëse në fushën e energjisë së ripërtëritshme

Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë nënkuptojnë përdorimin e resurseve të ripërtëritshme si era, solare, nxehtësia gjeotermale, biogazi dhe biomasa në vend të lëndëve djegëse fosile. Zhvillimi i BRE-ve në Kosovë do të ndihmojë vendin në plotësimin e të paktën tri synimeve të politikave energjetike të shtetit: mbështetjen në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji dhe mbrojtjen e mjedisit. Zhvillimi i BRE-ve do të ndihmonte gjithashtu në arritjen e targetit obligativ të Kosovës prej 25% për BRE-të në kuadër të Komunitetit të Energjisë.

Mjetet më të mira për joshjen e investimeve në fushën e energjisë së ripërtëritshme dhe për rritjen e nivelit të energjisë së gjelbër në tregun energjetik janë masat nxitëse. Masat dhe politikat e shteteve në regjion dhe shteteve të BE-së në lidhje me promovimin dhe mbështetjen e burimeve të ripërtëritshme janë: tarifatat nxitëse fikse, masat në taksa, dhe kuotat për energjinë e ripërtëritshme.¹⁷

Tarifatat nxitëse i mundësojnë prodhuesve të energjisë alternative mbulimin e kostos së prodhimit për një kohë të caktuar, duke i bërë më konkurrues në treg. Politika e tarifave nxitëse mund të mendohet si një formë stimulimi e avancuar e bazuar në prodhim, kjo ngase pagesat bëhen për energjinë elektrike të prodhuar dhe jo për kapacitetin e instaluar. Pagesa më e zakonshme e tarifave nxitëse është e bazuar në koston aktuale të nivelizuar të energjisë së

¹⁶Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-184, për Energjinë, Prishtinë 2010.

¹⁷Masat në taksa aplikohen në atë mënyrë që investitori i huaj të lirohet nga taksat. Kjo praktikë është bërë me qëllim të uljes së kostos së investimit dhe të prodhimit të energjisë së ripërtëritshme. Sistemi i masave nxitëse në taksa aplikohet në vende si në Mbretëri të Bashkuar, Holandë, Slloveni, Finlandë etj. Ndërsa, sistemi i kuotave është gjerësisht i aplikuar dhe nënkupton vendosjen e një kuote minimale të energjisë së ripërtëritshme e cila patjetër duhet të vihet në treg ndaj energjisë tjetër.

pastër. Kjo mënyrë e pagesës ofron një çmim të përshtatshëm për të siguruar një normë të arsyeshme të kthimit të investimit për investitorët.

Për shkak të lehtësisë së aplikimit dhe efikasitetit të tyre, tarifatat nxitëse janë mekanizmi më i përdorur në Evropë për stimulimin e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Në tabelën më poshtme janë të paraqitura masat nxitëse të aplikuara të 27 vendet anëtare të BE-së. Nga tabela shihet se tarifatat nxitëse janë më të përdoruara.

27 vendet anëtare të BE-së	Masat nxitëse		
Shteti	Tarifatat nxitëse fikse	Masat në taksa	Kuotat për energjinë nga burimet e ripërtëritshme
Austria	x		
Belgjika	x	x	X
Bullgaria	x		
Qipro	x		
Republika Çeke	x		
Gjermania	x		
Danimarka	x		
Estonia	x		
Spanja	x	x	
Finlanda		x	
Franca	x		
Greqia	x	x	
Hungaria	x		
Irlanda	x		
Italia	x		x
Lituania	x		
Luksemburgu	x		
Latvia	x	x	

Malta	x		
Holanda		x	
Polonia		x	X
Portugalia	x		
Rumania			X
Suedia		x	X
Sllovenia	x		
Sllovakia	X	x	
Mbretëria e Bashkuar	X	x	X

5. Rëndësia e tarifave nxitëse

Vende të ndryshme gjithnjë e më tepër janë duke përdorur energjinë nga burimet e ripërtëritshme për të zbutur ndryshimet klimatike. Rol të rëndësishëm në këtë proces kanë luajtur politikat e brendshme të ndërmarra për formën e masave mbështetëse të çmimeve si tarifave nxitëse. Tarifave nxitëse kanë luajtur një rol në nxitjen e investimeve shumë të nevojshme publike dhe private, të brendshme dhe të huaja në sektorin e energjisë së ripërtëritshme në vendet e BE-së dhe vendet e rajonit.

Në mesin e shumë formave të nxitjes së investimeve për BRE, tarifave nxitëse janë parë si më të përshtatshmet për të mbuluar një pjesë të kostos së prodhimit të energjisë së pastër. Edhe në rastet kur janë ndërmarrë masa të tjera stimulese, tarifave nxitëse prapë se prapë janë vënë si kombinim i masave të tjera. Ky lloj tarife është mekanizmi më i preferuar i Komisionit Evropian (KE), siç shënohet në planin e KE-së për rritjen e konsumit të energjisë nga BRE-të dhe reduktim të emisioneve të CO₂ për periudhën deri në vitin 2025.

Politika e tarifave nxitëse ofron një metodë tejte të mirë për të nxitur zhvillimin e shpejtë të burimeve të ripërtëritshme, duke përfituar tarifë paguesit, zhvilluesit e energjisë së pastër dhe shoqëria në përgjithësi. Rëndësia e politikave të tarifave nxitëse qëndron në atë që ofrojnë një

mjedis të qëndrueshëm investimesh dhe shfaqin siguri afatgjate të kushteve të pagesës. Tarifa nxitëse është duke u bërë politika kyçe e cila është duke u përdorur për të zhvendosur miksin energjetik nga lëndët djegëse fosile në BRE për të adresuar sigurinë e furnizimit energjetik, ndryshimet klimatike dhe rritjen ekonomike. Avantazhet e energjisë elektrike gjeneruese nga BRE-të janë pranuar gjerësisht. Mirëpo, zhvillimi i BRE-ve kërkon një seri stimuljesh, sepse teknologjitë e tyre nuk mund të konkurrojnë në tregun e energjisë me teknologjitë konvencionale të prodhimit të energjisë.¹⁸ Megjithatë, vlen të theksohet fakti se kostoja e një pjesetë teknologjive të BRE-ve që nga viti 1960 dhe 1970 është gjithnjë e duke u bërë më e lirë.

Tarifat nxitëse zbatohen për të mbështetur të gjitha teknologjitë e burimeve tëripërtërishme: erë, diellore, biogaz, biomasë, gjeotermale. Në qoftë se nivelet e pagesave janë të ndara si duhet, tarifet nxitëse mund të rrisin zhvillimin e llojeve të ndryshme të teknologjisë mbi një zonë të gjerë gjeografike duke kontribuar në krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e energjisë së pastër në sektorë të ndryshëm të teknologjisë. Përdorimi dhe suksesi i tarifave nxitëse nëpër botë e sidomos në Evropë¹⁹, jep përshtypjen se rëndësia e tarifave nxitëse do të vazhdojnë të rritet edhe për Kosovën, ngase ato ofrojnë një kornizë të suksesshme për investime si dhe nxitjen e zhvillimit të energjisë së ripërtërishme dhe krijimin e vendeve të punës.

Tarifat nxitëse fikse kanë dëshmuar të jenë më të efektshme: Çmimet e paguara për energjinë e erës në Mbretërinë e Bashkuar dhe Itali (pa tarifa fikse) janë më të larta se tarifet nxitëse fikse. Për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar paguan rreth 1/3 më shumë për energjinë e erës se Gjermania.²⁰ Një dallim i tillë është për shkak të mossigurisë së çmimeve.

Ligji i Kosovës për Energjinë Elektrike sugjeron përdorimin e skemës së tarifave nxitëse, si dhe përdorimin e Certifikatave të Origjinës. Përvoja ndërkombëtare sugjeron që tarifet nxitëse janë veçanërisht efektive në promovimin e përdorimit të energjisë së pastër për prodhimin e

¹⁸Rexha, B, Dragusha, B, 'Shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë në Kosovë deri në vitin 2020', Konferenca e tretë Ndërkombëtare për Energji dhe Ndryshime Klimatike, Athinë, 2 tetor 2010.

¹⁹Nga 27 vende anëtare të BE-së, 21 vende janë implementuese të politikës së tarifave nxitëse përveç: Danimarkës, Finlandës, Holandës, Polonisë, Rumanisë dhe Suedisë.

²⁰Skemat nxitëse për energjinë e ripërtërishme, Marrë nga:

<http://www.greenrhinoenergy.com/renewable/context/incentives.php>.

energjisë elektrike. Investitorët preferojnë tarifën nxitëse për shkak se ato ofrojnë siguri të të ardhurave nga shitja e energjisë elektrike të prodhuar nga BRE-të.

Përcjellja e praktikave më të mira mund të kontribuojë në sigurimin e suksesit, efikasitetit të kostos, dhe performancën e përgjithshme të politikave të arsyeshme. Politikën më të suksesshme të tarifave nxitëse janë të bazuara në çmimet e ofruara për furnizuesit në koston e prodhimit të nivelizuar të energjisë alternative në mënyrë që të sigurojë një normë të arsyeshme të kthimit të investimit. Praktika të tjera të mira përfshijnë ofrimin e afat-gjatë të kontratave; diferencimin e lartësisë së tarifave nxitëse sipas llojit të teknologjisë, madhësisë së projektit dhe cilësinë e burimeve; tarifën degresive, një tipar i projektimit që përfshin një rënie në lartësinë e tarifave nxitëse me kalimin e kohës për të inkurajuar risitë dhe për të përshpejtuar ritmin e vendosjes, duke siguruar procedurë të efektshme administrative.

6. Tarifën nxitëse dhe llojet e tyre

Varësisht nga lloji i energjisë që prodhojnë tarifën nxitëse janë të ndryshme. Niveli i tarifës nxitëse varet nga teknologjia, madhësia dhe tipi i sistemit. Tarifën nxitëse për energji të erës dhe energji hidrike në të shumtën e rasteve janë më të ulëta sesa tarifën e llojeve tjera të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Çmimet e ulëta janë pasojë e faktit që kostoja e instalimit për prodhim të energjisë nga biomasa, burimet gjeotermale dhe solare konsiderohet të jenë më të larta. Prandaj, edhe investitorët që investojnë në këto lloje të energjisë, përfitojnë tarifën më të lartë nxitëse. Në Kosovë janë të përcaktuara tarifën nxitëse për energji hidrike, të erës, biogaz dhe biomasë ndërsa tarifën nxitëse për prodhimin e energjisë solare dhe ajo gjeotermale mungojnë.

Tarifën e përcaktuara janë fikse dhe formulat me të cilat duhen kalkuluar ato nuk janë të përcaktuara me ligj. Në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, është zyra e Rregullatorit të

Energjisë (ZRRE) ajo që me vendime të veçanta përcakton lartësinë dhe metodologjinë e vlerësimit të tarifave.²¹

Tarifat nxitëse synojnë që investitorit t'i sigurojnë një kontratë afatgjate të garantimit të çmimit me të cilin investimi do të shpërblehej. Në disa raste mund të aplikohet një mekanizëm i quajtur 'ulja e tarifës' (tariffdegression) me anë të së cilit me kalimin e kohës bëhet ulja graduale e tarifave nxitëse.

Shpesh supozohet se për panelatsolarefotovoltaike, vendet me më pak diellgjatë vitit dhe çmime më të ulëta të energjisë nga burimet konvencionale do të paguajnë një tarifë më të lartë se vendet të cilat kanë diellosjetë madhe. Edhe në Kosovë shpesh hasim në deklarata të tilla që Kosova nuk ka diellosje të madhe andaj edhe çmimi i energjisë nga dielli do të rezultonte në çmime të larta për konsumatorët. Mirëpo, një supozim i tillë nuk qëndron. Tarifat nxitëse në vitin 2008 në Spanjën me diell dhe në Gjermaninë me më pak diell janë pothuaj të njëjta përderisa Greqia e cila ka diellosjetë më të ulëta paguante 20 cent më shumë për kWh se sa Spanja dhe Gjermania. Në fakt, vërehet se ka një lidhje mes të nivelit të tarifave nxitëse dhe hendekut për të arritur objektivin e caktuar të BE-së për BRE-të deri për vitin 2020. Vendet që janë ende larg targetit të tyre priren të ofrojnë çmime më të larta, siç është edhe rasti i Kosovës.

Tarifat nxitëse kanë për qëllim arritjen e një kontrate afatgjate me investitorin, qoftë ai pronar shtëpie apo i ndonjë kapaciteti më të madh. Praktikisht e shteteve evropiane tregojnë se tarifat nxitëse vihen për një periudhë afatgjate prej 15-25 vite. Kohëzgjatja e tarifave nxitëse në Kosovë është e përcaktuar për një periudhë më të shkurtër kohore se sa në vendet të rajonit, për vetëm 10 vite. Kohëzgjatja e kontratave për tarifa nxitëse është një element thelbësor nxitës apo dekurajues për një investitor, qoftë ai i huaj apo vendor. Një kohëzgjatje e tillë e tarifave nxitëse nuk është arsyetuar nga ZRRE dhe mbetet një nga shqetësimet kryesore të investitorëve.

²¹Kuvendi i Kosovës, LIGJI Nr. 03/L-185, për Rregullatorin e Energjisë, Prishtinë 2010.

a) Lartësia e tarifave nxitëse

Tarifat nxitëse në Kosovë, të cilat janë të përcaktuara, edhe pse dallojnë me ato të vendeve të rajonit, janë relativisht të kënaqshme. Sidoqoftë, tarifat e energjisë solare dhe energjisë gjeotermale në Kosovë nuk janë të përcaktuara ende. Tarifat e përcaktuara janë fikse dhe formulat me të cilat duhen kalkuluar ato nuk janë të përcaktuara me ligj. Në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, është zyra e Rregullatorit të Energjisë ajo që me vendime të veçanta përcakton lartësinë dhe metodologjinë e vlerësimit të tarifave.²² Kështu, kjo zyrë nxjerr vendime në lidhje me tarifat nxitëse, lartësinë dhe kohëzgjatjen e tyre.

Dallime në mes të Kosovës dhe vendeve të krahasuara në këtë analizë shihen edhe në kohëzgjatjen e kthimit të investimit. Kjo ndodh pasi Kosova ka tarifat më afatshkurtra në rajon dhe rrjedhimisht është në pozicion më pak të favorshëm në krahasim me vendet tjera në drejtim të nxitjes së investimeve nga jashtë. Gjithashtu, Kosova nuk ka ndërmarrë hapa në drejtim të nxitjes së investimeve qoftë nga investitorët privat, qoftë përmes marrëveshjeve bilaterale me shtete të tjera.

Tabela në vazhdim, tregon lartësinë e tarifave nxitëse të aplikueshme për energjinë elektrike nga burimet e ripërtëritshme në Kosovë.²³

	Hydroenergji (<10 MW)	Solare	E erës	Biomasës	Gjeotermale
	Shprehur në €/MWh				
Tarifa nxitëse	63.3	/	85.0	71.3	/

Përgjatë analizës shihet se Kosova ka vendosur tarifa nxitëse për energji hidrike që janë relativisht të ulëta në krahasim me vendet e rajonit por edhe vendet e Evropës. Tarifat për


²²Kuvendi i Kosovës, LIGJI Nr. 03/L-185, për Rregullatorin e Energjisë, Prishtinë 2010.

²³Zyra e Rregullatorit për Energji, Vendim V_359_2011, Tarifat nxitëse për Energjinë e Ripërtëritshme. Marrë nga: http://ero-ks.org/Vendimet/Shqip/2011/Vendimi_V_359_2011.pdf.

energji të erës janë po ashtu të ulëta në krahasim me tarifatat më të mëdha që aplikohen në vende të Evropës, si dhe në raport me vendet e rajonit.

Hydroenergji

Kosova ka përcaktuar tarifa që për hidrocentrale (<10MW kapacitet të instaluar) kanë çmimin 6.33 €cent/kWh. Për të njëjtin kapacitet, Gjermania ka përcaktuar tarifën prej 5.50 €cent/kWh, ndërsa Shqipëria, Maqedonia dhe Sllovenia kanë tarifë më të lartë se Kosova, 8.0 €cent/kWh. Nga ky krahasim del se niveli i tarifave nxitëse për kapacitetet hidrike deri 10 MWi Kosovës është më i ultë sesa niveli i vendeve të rajonit.



Të dhënat në mënyrë grafike mbi lartësinë e tarifave nxitëse për energji hidrike në Kosovë dhe në vendeve tjera krahasuese në këtë analizë të ndara në bazë të kapacitetit të prodhimit.


Vendet si Gjermania, Shqipëria dhe Greqia, kanë përcaktuar tarifa për kapacitete edhe më të mëdha sesa 10 MW. Madje Gjermania ka përcaktuar edhe tarifa për kapacitete mbi 50 MW. Serbia ka limituar kapacitetin deri në 10 MW kurse tarifatat nga 7.8 €cent/kWh deri në 9.7 €cent/kWh. Në rastin e Serbisë vlen të përmendet se gjysma e kapaciteteve energjetike të Serbisë është e varur nga energjia hidrike dhe shteti serb ka nxitur investime në kuptimin e shfrytëzimit të kapaciteteve të saja. Në një marrëveshje bilaterale me Italinë, Serbia është pajtuar që Italia të shfrytëzojë burime të energjisë së ripërtëritshme hidrike të saj në këmbim të

tarifave nxitëse më të mëdha në Evropë.²⁴ Këto tarifa do të jenë 155 €/MWh, përkatësisht 15.5 €cent/kWh. Në këtë drejtim Serbia ka siguruar të ardhura buxhetore më të mëdha për një periudhë të kënaqshme kohore.

Energjia e erës

Sa i përket tarifave për energjinë e erës, duhet thënë se tarifa më e lartë në Evropë është 16.11 €cent/kWh kurse më e ulëta 5.89 €cent/kWh. Kosova ka përcaktuar një vlerë tarifore prej 8.5 €cent/kWh, Maqedonia 8.9 €cent/kWh, Mali i Zi 9.6 €cent/kWh kurse Sllovenia 9.5 €cent/kWh. Serbia ka një shifër më të ulët prej 2.3 €cent/kWh. Gjermania aplikon edhe bonuse për energjinë që fitohet nga era që vjen në drejtim nga deti për tek bregdeti (onshorewind). Njëkohësisht, Gjermania ka sasinë më të madhe të tarifës së bonusit që aplikon për këtë lloj energjie, 19 €cent/kWh.

Nga të dhënat e prezantuara (më poshtë) për lartësinë e tarifave nxitëse të energjisë së erës, shohim se niveli i tyre në Kosovë nuk dallon shumë me ato të vendeve të rajonit. Kjo ngase, tarifat nxitëse në Kosovë për prodhimin e energjisë elektrike nga eranëpërmjet teknologjive të reja, janë të kalkuluara nga mesatarja e normave të kompensimit të shteteve fqinje.



²⁴ReservoirCapital, (2012), RenewableEnergy in SoutheastEurope, Italian TariffsforSerbianEnergy, Marrë nga: <http://www.reservoircapitalcorp.com/i/pdf/CorpPres.pdf>.

Kërkesat e deri tashme për kycjen në rrjetin elektrik janë tregues të potencialeve për prodhim energjie nga era në Kosovë. Që nga viti 2009 për kycje në rrjet elektrik kanë aplikuar disa investitor të cilët kanë planifikuar kapacitetin total prej 157 MW. Në KOSTT janë paraqitur tri aplikacione për kycjen e turbinave me erë në rrjetin elektrik:

- projekti i Shtimes1 me kapacitet prej 100 MW, pjesa juglindore e Kosovës,
- projekti i Shtimes2 me kapacitet prej 27 MW, pjesa juglindore e Kosovës
- projekti Kitka me kapacitet prej 30 MW-pjesa lindore e Kosovës.²⁵

Biomasa

Sa i përket energjisë së biomasës, tarifat më të larta në Evropë janë 23.61 €cent/kWh kurse ato më të ulëta janë 6.18 €cent/kWh. Mbretëria e Bashkuar, Bullgaria dhe Sllovakia kanë tarifat më të ulëta në këtë burim energjie, kurse vendet si Italia dhe Republika Çeke, kanë tarifat më të larta në këtë lloj të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Tarifa nxitëse e aplikueshme për energjinë elektrike të prodhuar nga biomasa në Kosovë është 7.13 €cent/kWh. Për kapacitete deri në 1 MW, Kroacia ka vendosur tarifa prej 12.7 €cent/kWh kurse Greqia 20 €cent/kWh dhe Sllovenia 22.4 €cent/kWh. Për kapacitete më të mëdha deri në 20 MW, Gjermania ka përcaktuar një shifër prej 6 €cent/kWh. Siç vërehet, lartësia e tarifave për energji të biomasës në Kosovë është relativisht më e ultë sesa në vendet e tjera.

Nxitja e investimeve dhe zhvillimi i prodhimit të energjisë elektrike nga biomasa do të ishte përfitim i dyfishtë. Kjo pasi shfrytëzimi i mbeturinave si masë për prodhimin e energjisë do të ulte nivelin e tyre të përgjithshëm dhe njëkohësisht do të mundësonte prodhim të energjisë nga një burim i ripërtëritshëm.

²⁵ Plani Zhvillimor i Transmisionit 2012 - 2021, KOSTT, Prishtinë 2011. Marrë nga: http://www.kostt.com/website/images/stories/dokumente/tjera/Plani_Zhvillimor_i_Transmisionit_2012_-_2021.pdf.

Gjeotermale


Kosova gjithashtu nuk i ka të përcaktuar tarifën nxitëse për prodhimin e energjisë termike nga burimet gjeotermale. Ndër vendet me tarifa më të larta për energjinë gjeotermale, janë Gjermania me një tarifë prej 25 €cent/kWh, kurse Zvicra me tarifë prej 27.7 €cent/kWh. Ndërsa nga vendet e rajonit, Kroacia ka vendosur një tarifë prej 15.9 €cent/kWh, Sllovenia 15.2 €cent/kWh, kurse Serbia dhe Mali i Zi kanë tarifa tejet të ulëta me 7.5 €cent/kWh përkatësisht 5.9 €cent/kWh.

Energjia Solare

Kosova ende nuk ka e të përcaktuar tarifën nxitëse për energjinë solare. Tarifa më e lartë në Evropë për energjinë solare të kapaciteteve të vogla është 59 €cent/kWh e Zvicrrës, pastaj Bullgaria dhe Sllovakia që kanë 38.9 €cent/kWh, përkatësisht 38.2 €cent/kWh. Ndër vendet evropiane me tarifa më të ulëta në energjinë solare të kapaciteteve të ulëta janë Gjermania me 19.5 €cent/kWh, Franca me 20.4 €cent/kWh dhe Mbretëria e Bashkuar me 24.1 €cent/kWh. Zvicra ka tarifën më të lartë për centrale solare me kapacitet të lartë, me çmim prej 35.3 €cent/kWh, ndërkohë që Franca dhe Gjermania i kanë më të ulëta. Vende si Serbia, Mali i Zi dhe Sllovenia kanë përcaktuar tarifa të përgjithshme për këtë burim energjie. Këto tarifa ndryshojnë nga 23 €cent/kWh e Serbisë, në 15 €cent/kWh e Malit të Zi dhe 28.8 €cent/kWh e Sllovenisë. Vendet e tjera nuk kanë aplikuar një tarifë të përgjithshme por ajo ndryshon varësisht nga kapaciteti prodhues. Për shembull, Maqedonia ka përcaktuar tarifa të ndryshme për kapacitete të ndryshme prodhimi, si Gjermania dhe Kroacia. Vlen të theksohet se Greqia ka shifrat më të larta të tarifave nxitëse për energjinë solare me 39.20 €cent/kWh për centrale solare të kapacitetit mbi 100 kW, ndërkohë që Gjermania ka tarifë më të ulët edhe për centrale që nuk kalojnë mbi 100kW, përkatësisht 21.98 €cent/kWh për këto centrale.

Sa i përket energjisë solare duhet theksuar se vende si Gjermania, për dallim nga viti 2004 që tarifat për energjinë deri në 100 kW e kishte 57.4 €cent/kWh, tani i ka zbritur në 21.98 €cent/kWh. Kjo rënie drastike i është aplikuar edhe kapaciteteve të vogla. Në vitin 2012 Gjermania ka aplikuar tarifën ulëse (degresive) e cila u çek më lartë dhe atë në ulje vjetore deri në 29% për kapacitete solare që prodhojnë 7500 MW në vit. Gjermania përbën një shembull shumë të mirë të funksionimit të politikës së tarifave nxitëse. Që nga vendosja e tarifave nxitëse

në vitin 2000, Gjermania ka rritur dukshëm nivelin e ofertës së energjisë së ripërtëritshme. Siç shihet në grafikun e mëposhtëm, pas aplikimit të skemës së tarifave nxitëse, Gjermania ka ngritur nivelin e energjisë së ripërtëritshme si rrjedhojë e nxitjes së investimeve në këtë fushë në mesatarisht 72 për qind gjatë viteve.



Niveli instalues global i energjisë solare.²⁶

Sipas investitorëve potencial në Kosovë, në qoftë se i referohemi rajonit, numrit të orëve të diellosjes në Kosovë brenda vitit dhe problemeve teknike që të subvencionohet dhe fuqizohet segmenti i burimeve të ripërtëritshme e sidomos asaj me energji solare propozojnë të kemi këto tarifa nxitëse: deri 50kW – çmimi i shitjes të paguhet rreth 13-15 €cent/kWh, dhe mbi 50kW – çmimi i shitjes të paguhej rreth 11-13 €cent/kWh.²⁷ Shifra të tilla, sipas investitorëve potencial në energji solare argumentohen dhe arsyetohen me faktin se: për dallim nga burimet e tjera të energjisë së pastër teknologjia për energji nga dielli ende është pak më shtrenjtë se nga burimet tjera të energjisë. Energjia nga dielli edhe në Kosovë është më produktive sepse

²⁶Niveli instalues global i energjisë solare. Marrë nga "The economicsofFeed-in Tariffsfor Solar PV in Australia", Report by Access EconomicsPtyLimitedforCleanEnergyCouncil, 2008.

²⁷Intervistë e INDEP me LulzimSyla, Drejtor për Marketing & Zhvillim N.T.SH. "ELEN", Kosovë, Maj 2013.

tek ne ka mjaft mirë diellosje, do të ishin indikatorë nxitës për investimet jashtme dhe e fundit të kontribuonin që të plotësojmë kuotën minimale për të implementuar planin që kërkohet për përmbushjen e targetit prej 25%.

Shteti	Hidroenergji	Erë	Biomasë	Solare	Gjeotermale
Kosova	6.3 €cent/kWh	8.5 €cent/kWh	7.13 €cent/kWh	/	/
Shqipëria	8.0 €cent/kWh				
Maqedonia	8.0 €cent/kWh	8.9 €cent/kWh	13 €cent/kWh	46 €cent/kWh	
Mali i Zi		9.6 €cent/kWh		15 €cent/kWh	5.9 €cent/kWh
Serbia	9.7 €cent/kWh	2.3 €cent/kWh		23 €cent/kWh	7.5 €cent/kWh
Kroacia			12.7 €cent/kWh		15.9 €cent/kWh
Bullgaria				38.9 €cent/kWh	
Greqia	25 €cent/kWh	8.7 €cent/kWh	20 €cent/kWh	39.204 €cent/kWh	15 €cent/kWh
Sllovenia	8.0 €cent/kWh	9.5 €cent/kWh	22.4 €cent/kWh	28.8 €cent/kWh	15.2 €cent/kWh
Gjermania	5.5 €cent/kWh	19 €cent/kWh	6 €cent/kWh	19.5 €cent/kWh	25 €cent/kWh
Zvicra				59 €cent/kWh	27.7 €cent/kWh
Franca	6.07 €cent/kWh	8.2 €cent/kWh	12.5 €cent/kWh	20.4 €cent/kWh	<12 MW – 20 €cent/kWh
Sllovakia	10.9 €cent/kWh	7.92 €cent/kWh	11.3 €cent/kWh	38.2 €cent/kWh	19.6 €cent/kWh
Mbretëria e Bashkuar				24.1 €cent/kWh	


Nga analizimi i të gjithë këtyre shifrave, vërehet se lartësia e tarifave nxitëse në Kosovë, të paktën ato që janë të përcaktuara, janë relativisht në nivel të vendeve të rajonit dhe vendeve të tjera. Kosova ka lartësi të tarifave për hidroenergji të ngjashme me Gjermaninë. Tarifat nxitëse për energji të erës në Kosovë janë të ngjajshme me ato të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Francës. Niveli i kënaqshëm i lartësisë së tarifave nxitëse shprehet edhe nga investitorët të cilët përgjithësisht janë të kënaqur me lartësinë e tyre.²⁸ Sipas tyre një lartësi e tillë e tarifave nxitëse u siguron një profit të mjaftueshëm për të siguruar investimin e tyre.²⁹ Lartësia e tarifave nxitëse për burimet e energjisë hidrike, të erës dhe biomasës janë relativisht në linjë me masat nxitëse të vendeve të tjera.

²⁸Intervistë e INDEP me HamdiMalushajn, kryetar i Shoqatës për Energji të Ripërtitshme të Kosovës (SHERK), Kosovë, Qershor 2012.

²⁹Intervistë e INDEP me SahitVokshin, drejtor i kompanisë "AirEnergy", Kosovë, Korrik 2012.

b) Kohëzgjatja e tarifave nxitëse

Nga krahasimi i Kosovës me vendet tjera, vërehen dallime në kohëzgjatjen e tarifave nxitëse. Kosova aplikon tarifa me kohëzgjatjen më të ulët të tyre në rajon dhe me vendet e BE-së. Tarifat me kohëzgjatje prej vetëm dhjetë vitesh janë të dëmshme për investitorët. Kohëzgjatja sa më e madhe e këtyre tarifave, u jep investitorëve më shumë siguri në investimin e tyre. Grafiku në vazhdim tregon kohëzgjatjen e tarifave nxitëse nëpër vende të ndryshme:



ZRRE nuk ka arsyetuar mjaftueshëm përcaktim e një kohëzgjatje kaq të shkurtër të kontratave për tarifa nxitëse. Përderisa Kosova ka paraparë që tarifatat për energjinë hidrike, të erës dhe biomasës të kenë kohëzgjatje prej 10 vite, shtetet e tjera kanë kohëzgjatje më të madhe. Kështu, vendet e rajonit si Serbia, Kroacia dhe Mali i Zi kanë kohëzgjatje të tarifave prej 12 vitesh. Shqipëria dhe Sllovenia kanë kohëzgjatje prej 15 vitesh kurse vendet si Maqedonia, Greqia dhe Gjermania kanë kohëzgjatje prej 20 vitesh. Andaj disavantazhi i Kosovës në raport me vendet e rajonit përveç burokracisë së lartë për marrje të autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme rezulton të jetë edhe afati i kontratës për tarifatat nxitëse.

ZRRE, në Raportin Konsultativ për Shqyrtimin e tarifës nxitëse për Hidrocentralet e Vogla, kohëzgjatjen kaq të ulët e ka arsyetuar me vetëm një fjali. 'Duke marrë parasysh koston e

investimit dhe kohën mesatare të maturitetit të kredive për investime të mëdha dhe afatgjata është vendosur që tarifa të llogaritet si një mesatare për 10 vite'.³⁰ Një arsyetim i tillë është jo i mjaftueshëm dhe i mangët për një element kaq të rëndësishëm për një investitor, siç është ai i kohëzgjatjes së tarifave nxitëse. Është tejet e disfavorshme për Kosovën që të ketë kohëzgjatjen më të vogël të tarifave nxitëse në rajon. Për një investitor të huaj, kohëzgjatja e tarifave është garantuesi kryesor i investimit të tyre dhe sigurisht se një kohëzgjatje e tillë prej vetëm 10 vitesh do të duhej të arsyetohej më hollësisht sesa me vetëm një fjali. Kohëzgjatja e tarifave nxitëse paraqet shqetësim për investitorët. Sipas tyre, kohëzgjatja minimale prej dhjetë vitesh është jashtëzakonisht e vogël dhe se nuk janë të kënaqur me këtë afat ekzistues.³¹ Ky afat i shkurtër kontribuon në rritjen e riskut të investimit të tyre. Pra megjithëse investitorët janë të kënaqur me lartësinë e tarifave nxitëse, mbesin të pakënaqur me kohëzgjatjen e tyre.

Skema e tarifave nxitëse për energjinë nga burimet e ripërtëritshme në Kosovë është e pakompletuar dhe nevojitet të përcaktohen tarifa edhe për llojet tjera të energjisë. Sipas zyrtarit të ZRRE-së, është duke u punuar metodologjia për caktimin e tarifave për energjinë e prodhuar nga panelatfotovoltaike (diellore) dhe sipas tyre në fillim të vitit 2014, tarifa do të jetë e përcaktuar³². Gjithashtu sipas zyrtarittë ZRRE-së, "gjatë procesit të caktimit të tarifës nxitëse për energjinë e prodhuar nga panelatfotovoltaike do të rishikohen edhe eventualisht zgjatja e afatit të kontratës nga 10 vite në kohëzgjatjen prej 15 viteve"³³.

Është tejet e rëndësishme dhe e nevojshme që tarifat nxitëse për energjinë gjeotermale dhe nga ajo solare të përcaktoheshin, kur dihet se Kosova ka një diellosje mesatare prej 5.7 orë në ditë. Një diellosje e tillë është më e lartë sesa ajo e Gjermanisë që ka 4.8 orë në ditë, e po ashtu edhe vende të tjera kanë një diellosje të ngjashme (apo edhe më të pakët) dhe i kanë të përcaktuara tarifat nxitëse.

³⁰Zyra e Rregullatorit për Energji, Shqyrtimi i Feed-in Tarifës për Hidrocentralet e Vogla, Raport Konsultativ, Marrë nga: http://www.ero-ks.org/Price%20and%20Tariffs/Price%20and%20Tariffs%202008/Komentet_KEK_KOSTT_04_11_08/Komentet_ne_RAPORTIN_KONSULTATIV_per_feed-in_tariffat_KOSTT_alb.pdf.

³¹Intervistë e INDEP me SahitVokshin, drejtor i kompanisë "AirEnergy", Kosovë, Korrik 2012.

³²AfrimAjvazi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe tëLiçencimit, Dhjetor 2013

³³Ibid.

Ndonëse Kosova nuk ka shifra të sakta sa i përket kapaciteteve gjeotermale, statistikat dhe hartat e vendeve të rajonit japin të dhëna të rëndësishme që do të mund të vlenin edhe për Kosovën. Si shembull, në hartën e burimeve gjeotermale të Serbisë, figuron edhe Kosova.³⁴ Maqedonia është konsideruar të ketë potencial për të prodhuar 210,000 MWh (210 GWh) energjigjeotermale në vit, ndërsa Serbia ka potencial është 800 MW,³⁵ andaj potenciali që Kosova ka, nuk mund të jetë i nivelit shumë më të ulët.

Lartësia e tarifave nxitëse është e kënaqshme megjithatë kohëzgjatja e tyre është më e ulëta në rajon por edhe ndër vendet e tjera. Deri sa në rajon shifra më e ulët është dymbëdhjetë vite dhe më e gjata deri në njëzet vite, Kosova ka aplikuar një kohëzgjatje prej vetëm dhjetë vitesh që nuk garanton sa duhet investimet në këtë fushë. Tarifat nxitëse janë bazë për nxitjen e investimeve në shfrytëzimin e energjisë nga burimet eripërtërishme, rrjedhimisht kohëzgjatja e tyre është element kyç për investitorët të cilët janë të interesuar të investojnë.

7. Certifikatat e Gjelbra

Përveç tarifave nxitëse, një sistem tjetër që gjithnjë e më shumë është duke u përdorur është ai i certifikatave të gjelbra. Certifikatat e Gjelbra janë tituj ligjorë që tregtohen në disa vende të BE-së dhe që blihen nga kompanitë ndotëse të ambientit. Certifikatat e gjelbra janë tituj që shiten nga prodhuesit e energjisë elektrike të pastër dhe mjedisore, si energjia e erës e ajo e ujit.³⁶ Kjo mundëson krijimin e një tregu të certifikatave të gjelbra dhe gjithashtu shërbejnë si mjete për matjen e energjisë së gjelbër që qarkullon në rrjetën energjetike.

Certifikatat e gjelbëra janë të krijuar nga prodhuesit e energjisë elektrike. Prodhuesit marrin një certifikatë për çdo njësi të paracaktuar të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e

³⁴ Daniel M. Kammen, MaryamMozafariandDanielPrull, SustainableEnergyOptionsforKosovo. An analysisofresourceavailabilityandcost, UniversityofCalifornia, Berkeley, Janar 2012.

³⁵ Daniel M. Kammen, MaryamMozafariandDanielPrull, SustainableEnergyOptionsforKosovo. An analysisofresourceavailabilityandcost, UniversityofCalifornia, Berkeley, Janar 2012.

³⁶ BusinessInsight, The Outlook forGreenCertificateMarkets in Europe, Marrë nga: <http://www.globalbusinessinsights.com/content/rben0166m.pdf>.

ripërtëritshme të energjisë që është vënë në rrjet. Kërkesa për certifikatat e gjelbra mund të vijë nga disa burime. Kërkesa mund të vijë edhe nga qeveria për konsumatorët apo akterët e tjerë në zinxhirin e furnizimit me energji elektrike (gjeneratorë, shpërndarësit, furnitorët) me anë të një detyrimi për të gjeneruar, të transmetojë, të dorëzojë ose ta blejë një sasi të caktuar të certifikatave të gjelbra. Vetë qeveria mund të veprojë si një blerës i certifikatave të gjelbra, p.sh. duke siguruar një çmim minimal ose me një procedurë të tenderimit. Në praktikë, kërkesa mund të vijë nga një kombinim i këtyre burimeve.

Sistemi i certifikatave të gjelbra mundëson kalkulimin e saktë të energjisë së pastër që konsumohet dhe asaj që hyn në rrjet. Një MW rrymë nga BRE-të ka vlerën e një certifikate. Me certifikata të gjelbra konsumatori fundorë i energjisë elektrike bënë financimin e teknologjive të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, nëpërmjet blerjes së certifikatave në treg. Prodhuesit e certifikuar të energjisë elektrike të gjelbër do të kenë të drejtën për të shitur një certifikatë në tregun e certifikatës për njësi të prodhuar të energjisë elektrike, p.sh. për kWh. Certifikatat janë kështu produktet e pastra financiare të cilat janë përdorur për të arritur një prodhim të dëshiruar nga investimet në BRE.

Komisioni Evropian e konsideron këtë sistem si një opsion për zvogëlimin shtrembërimeve të tregut për shkaqe të ndryshme të skemave të ndihmës shtetërore për energjinë nga burimet e ripërtëritshme në tregun e brendshëm të energjisë elektrike në zhvillim.

Një mekanizëm i certifikatave të gjelbra ka qenë në plan të implementohet në një të ardhme të afërt edhe në Kosovë³⁷, mirëpo ende nuk janë bërë hapa konkret në këtë drejtim. Ndër shtetet që aplikojnë sistemin e certifikatave të gjelbra janë Mbretëria e Bashkuar, Holanda, Belgjika, Italia dhe Serbia. Në Serbi, ligji i ri i Energjisë i miratuar me 28 Korrik 2011 ka paraparë që sistemin e certifikatave të gjelbra të e instalojë dhe të e menaxhojë Sistemi Serb i

³⁷ Rexha, Blerim, Dragusha, Bedri, Feed-in Tariffs in Kosovo, Marrë nga: <http://www.wseas.us/elibrary/conferences/2010/Cambridge/EE/EE-22.pdf>.

Transmisionit.³⁸ Megjithëse në rritje, sistemi i certifikatave të gjelbra është një sistem relativisht i ri në pjesën e Evropës, mirëpo dukshëm më i përdorur në Amerikë.

Sistemi i certifikatave të gjelbra është mjet edhe për nxitjen e investimeve dhe matjen e sasisë së energjisë së gjelbër që përdoret në konsumin final. Me hapjen e tregut të certifikatave të gjelbra mundësohet edhe tregtimi i tyre. Rrjedhimisht investitorët do të kishin interes më të madh që të investonin në këtë fushë. Meqë në shumicën e rasteve një certifikatë e gjelbër ka vlerën e një MW energjie të pastër, sasia e certifikatave të gjelbra në treg do të nënkuptonte edhe sasinë e energjisë së gjelbër që harxhohet në konsumin final. Një mekanizëm i tillë u ka mundësuar shteteve të kalkulojnë vazhdimisht nivelin e përmbushjes së caqeve për përdorim të energjisë nga burimet eripërtërishme.

8. Përfundimet

Kosova ka një potencial të kënaqshëm të burimeve të ripërtërishmepër prodhimin e energjisë që e bën tregun Kosovar treg të mirë për investime në fushën e energjisë së pastër. Meqë ka nevojë për masa incentive, tarifatat nxitëse janë aplikuar për këtë qëllim edhe në Kosovë për disa burime eripërtërishme të energjisë. Ekzistojnë studime të cilat vlerësojnë potenciale të Kosovës në fushën e energjisë së pastër si konkurrese me vendet e rajonit. Sidoqoftë studime të besueshme nga gjitha palët prapëseprapë janë të nevojshme.

Ligji për Energji i Republikës së Kosovës dhe Direktivat e BE-së kanë vënë një bazë të rregullimit të aspektit ligjor. Në Ligjin për Energji është paraparë detyrimi që kanë operatorët e transmisionit dhe distribucionit që të ofrojnë në dispozicion infrastrukturën e plotë për të mbështetur energjinë e prodhuar nga burime të ripërtërishme. Sidoqoftë, Ligji për Energji duhet të rihartohet sa më parë në mënyrë që të jetë konform Direktivës 2009/28/KE. Ndërsa, Strategjia e Energjisë (2009-2018) lë anash BRE-të dhe ka fokus të veçantë në linjit. Këtë vit

³⁸ BDk- Attorneys at Law, (2012), Serbia: Energy&NaturalRecourses, The NewLawonEnergy, Marrë nga: http://www.bdklegal.com/upload/documents/newsletter/2011/BDK_Newsletter_13_2011.pdf.

është e rëndësishme të bëhet rishikimi i Strategjisë së Energjisë siç edhe parashihet të bëhet çdo tri vite në mënyrë që të përfshihen në mënyrë më konkrete planet për BRE-të.

Duke qenë palë nënshkruese e Traktatit të Energjisë, Kosova ka marrë përsipër implementimin e të gjitha dokumenteve dhe obligimeve nga ana e BE-së në fushën e energjisë. Rrjedhimisht, Direktiva 2009/28/KE e BE-së është bërë e aplikueshme edhe për Kosovën. Kështu, Kosova ka përmbushur disa nga kërkesat e kësaj direktive për masa stimuluese në fushën e energjisë së pastër.

Sidoqoftë, MZHE përveç përcaktimit të caqeve indikative të cilat japin përshtypje se caktohen vetëm sa për të përmbushur obligimet ligjore që dalin nga ligjet e Kosovës dhe Traktati i Komunitetit të Energjisë, mungojnë atlase për tërë territorin e Kosovës se sa janë potencialet reale për prodhim të energjisë nga BRE-të. Në këtë mënyrë do të kishte analiza dhe raporte nga qeveria të bazuara në hulumtime të cilat do të mund të prezantoheshin tek investitorët potencial.

Lartësia e Tarifave nxitëse nga përshkrimi krahasimor dhe nga vlerësimet e investitorëve shihet si e kënaqshme dhe që përmbush kërkesat e investitorëve. Megjithatë tarifat nxitëse nuk janë vënë për të gjitha llojet e energjisë nga burimet eripërtëritshme në të cilat Kosova ka potenciale të zhvillimit. Gjithashtu, kohëzgjatja e kontratave është shumë e vogël dhe nuk i garanton investitorët se kostoja e investimit të tyre do të mbështetet mjaftueshëm nga ana e institucioneve të shtetit.

Problem i madh rezultojnë të jenë edhe pengesat për zhvillimin e BRE-ve që ndërlidhen me autorizimin ekzistues jo të harmonizuar që shpesh bien ndesh me, procedurat e licencimit që janë kryesisht të dizajnuara për projekte investuese të mëdha në kapacitete gjeneruese konvencionale, dhe nuk janë të përshtatshme për BRE-të.

Gjithashtu, problematik rezulton të jetë fakti se janë shumë autoritete të përfshira në procedurat administrative dhe të licencimit, procedura që duhet të thjeshtohen dhe të koordinohen për të proceduar aplikacionet e BRE-ve. Procedura këto të cilat vonojnë zhvillimin e një projekti të BRE dhe ndikojnë në tërheqjen e investitorëve të huaj, andaj duhet planifikuar

dhe bërë përpjekje serioze drejt një institucioni 'one-stop-shop' për t'u marrë me të gjitha aplikacionet administrative për projekte të BRE-ve. Në Kosovë ka aplikacione të cilat qëndrojnë në sirtarë të ZRRE-së tani e 2 vite për të marrë licencën dhe për të filluar punën.

Si përfundim, skema e tarifave nxitëse në Kosovë është e papërfunduar, politikat tarifore ekzistuese dhe ambienti investues, nuk janë shumë tërheqëse për ngritjen e investimeve në fushën e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Një vend i cili nuk ka një plan kombëtar për energjinë e pastër, që ka kohëzgjatjen e tarifa nxitëse më të ulët në rajon, ka procedurat e licencimi të komplikuar dhe që marrin shumë kohë dhe që nuk ka sistem të certifikatave të gjelbra nuk mundet të jetë vend atraktiv për investim dhe investitorët. Andaj si rezultat i këtyre disavantazheve dhe prioriteteve politike në fushën e energjisë Kosova duket se ofron një mjedis jo tejet të favorshëm për investim.

9. Rekomandimet

Duke marrë për bazë evidencën e gjendjes faktike si dhe përfundimet e kësaj analize, INDEP rekomandon ndryshimin e këtyre politikave dhe ndërmarrjen e këtyre hapave në fushën e nxitjes së investimeve në energjinë nga burimet eripërtëritshme, me theks të veçantë të tarifave nxitëse.

1. Strategjia e Energjisë së Kosovës duhet të përfshijë format alternative të energjisë siç janë, energjia nga era, energjia solare, biomasa dhe energjia gjeotermale.
2. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) duhet të rishqyrtojë vendimin për vendosjen e tarifave nxitëse për të gjitha burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe të rrisë kohëzgjatjen e tyre. Tarifa rënëse do të ishte opsionale, për sa kohë lartësia e tarifës të mbulojë së paku 15% të kostos së investimit.
3. Ministria për Zhvillim Ekonomik (MZHE) duhet të bëjë amandamentimin e Ligjit për Energji konform Direktivës së Bashkimit Evropian 2009/28/KE.

4. Ministria për Zhvillim Ekonomik duhet të bëjë hulumtime të detajuara për segmente të caktuara të burimeve të ripërtëritshmetë ndërlidhura me politikën e përgjithshme për nxitjen e investimeve të huaja.
5. Ministria e Zhvillimit Ekonomik përveç hartimit të planeve do të duhej të përcaktonte në mënyrë të detajuar masat që do të duhej ndërmarrë për të mundësuar arritjen e caqeve dhe matjen e nivelit të arritshmërisë së tyre.
6. Të krijohen lehtësime dhe reformim nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrinë tjera për nxitjen e investimeve në objektet dhe instalimet e burimeve alternative.³⁹
7. Të konsiderohet heqja e taksës doganore për këto produkte: panelasolare, turbina të vogla të erës, bioenergjisë dhe pajisje të tjera përcjellëse që ndihmojnë në rritjen e investimeve individuale dhe më të mëdha në BRE. Kjo gjë do të krijojë një situatë të favorshme tregu për rritjen e efikasitetit energjetik, interesimin për investim dhe shfrytëzim të BRE-ve.
8. Të krijohet 'One-Stop-Shop' në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për t'u marrë me të gjitha aplikacionet administrative për projekte të BRE-ve. Një ide të tillë ish Ministri i Zhvillimit Ekonomik⁴⁰ që një kohë të gjatë është duke e përmendur, mirëpo shenja për hapa konkret drejt realizimit një çështje të tillë nuk janë ndërmarrë ende.
9. Të shqyrtohet vendosja e sistemit të certifikatave të gjelbra për të kontrolluar nivelin e energjisë së gjelbër që konsumohet si dhe për të nxitur investimet nga jashtë. Një sistemi i tillë do të ndihmonte në rritjen e investimeve dhe krijimin e një tregu të certifikatave të gjelbra në Kosovë.

³⁹Nga disa studime të MEM, janë evidentuar mbi 70 vende për ndërtimin e HEC-eve të vogla të cilat kanë fuqi instaluese rreth 140 MW. Duhet të vazhdohet me projektin e Zhurit dhe të nxiten edhe forma tjera si energjia gjeotermale, nga era, dielli, etj.

⁴⁰Ish Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj. Tash më Ministër i Financave në Qeverinë e Kosovës, Maj 2013.